



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

INFORMACION DY MUJOR

PËR VERIFIKIMIN E KUSHTEVE TË ZBATIMIT TË MASËS SË SIGURIMIT PËR
PERSONAT E ARRESTUAR NË KUADËR TË PROCEDIMIT PENAL NR.122/2022

GJYKATES SE POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

TIRANË

E nderuar Zonja Gjyqtare,

Me vendimin Nr. 130, datë 23 Tetor 2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vendosur ndër të tjera masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim Ilir Metaj, i dyshuar i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” në 3 (tre) raste nga të cilat në 2 (dy) raste është kryer në bashkëpunim, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i cdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram” parashikuar nga nenet 260 dhe 25, 287/2 dhe 257/a/2 i K.Penal.

Me të njëjtin vendim, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vendosur masat e sigurimit personal “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” ndaj personave nën hetim:

- Monika Kryemadhi, e dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” në 2(dy) raste dhe në bashkëpunim, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” e kryer në bashkëpunim, dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe

- nëpunësve publikë, ose i cdo personi që ka detyrimin ligjor për deklarim*" parashikuar nga nenet 260 dhe 25, 287/2 dhe 257/a/2 i K.Penal;
- Piro Xhixho, i dyshuar për veprën penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë"* **e kryer në bashkëpunim**, parashikuar nga nenet 260 dhe 25 të Kodit Penal.
 - Ema Çoku, e dyshuar për veprën penale të *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"* **e kryer në bashkëpunim** parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal;

Nga aktet e këtij procedimi, ka rezultuar se personi nën hetim Ilir Metaj dyshohet se ka kryer veprën penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal në tre raste dhe konkretisht:

I. I pandehuri Ilir Metaj, në detyrën e Ministrit të Ekonomisë, Industrisë dhe Energjitikës, **ka ndërhyrë me autoritetin dhe influencën e tij që shoqëria "Debt International Advisory"** me administrator shtetasin Kastriot Ismailaj, të lidhë kontratën e CEZ Shpërndarje, me objektin asistimin e kësaj të fundit për të identifikuar debitorët fillimisht dhe më pas arkëtimin e borxheve të prapambetura.

Objekti i kontratës ka qënë detyrimi i të porositurit, të mbledhë prej debitorëve të porositësit, me mbështetjen dhe shpërblimin e porositësit të gjitha borxhet dhe kamatat që kanë kaluar afatin prej 90 ditësh, duke përdorur mjete juridike të përshtatshme. Nga kjo marrëveshje shoqëria "Debt International Advisory – Dega Shqipëri", ka arritur që të sigurojë/përfitojë/vjedhë përmes mashtrimit shumën 649, 803, 520 leke, e vërtetuar tashmë me një vendim të formës së prerë. Për të bërë këtë ndërhyrje ai ka kërkuar dhe ka marrë përfitime të parregullta nga shtetasi Kastriot Ismailaj.

I pandehuri Ilir Metaj, ka favorizuar dhe mbështetur shtetasin Kastriot Ismailaj të krijonte kontaktet me përfaqësuesit e CEZ Pragë dhe për më tepër, të krijonte besueshmëri para tyre si njeri i besuar i qeverisë shqiptare, rrjedhimisht duke qënë kështu njeriu i favorizuar për të marrë kontratën për mbledhjen e borxheve nëpërmjet DIA-s, sikurse rezultoi më pas.

I pandehuri Ilir Metaj, duke kërkuar dhe marrë prej shtetasit Kastriot Ismailaj shuma të konsiderueshme parashë, ndërkohë që ka qënë Ministër i Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës, Ministri e cila kishte si detyrë funksionale një pjesë të procedurës së privatizimit të CEZ, mbikqyrjen e kontratës nëpërmjet caktimit të përfaqësuesve në Këshillin Mbikqyrës, si dhe mbikqyrjen e veprimtarisë. Shoqëria DIA me administrator shtetasin Kastriot Ismailaj, ka lidhur një kontratë fitimprurëse me CEZ pikërisht në saj të influencës dhe imponimit të Ministrit, të pandehurit Ilir

Metaj i cili si shpërblim ka marrë shuma monetare prej shtetasit Kastriot Ismailaj. Në këto rrethana i pandehuri Ilir Metaj, ka konsumuar në këtë mënyrë elementët e figurës së veprës penale të *“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore dhe të zgjedhurve vendore”* parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

- II. I pandehuri Ilir Metaj dhe personi nën hetim Monika Kryemadhi, kanë konsumuar veprën penale të *“Korrupsionit pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror dhe të zgjedhurve”*, pasi nga analiza e fakteve dhe provave të sigurura nga hetimi, rezulton se në funksion të interesave të tyre ekonomike-korruptive që kanë patur me shoqëritë UNIFI HOLDING INC dhe UNIFI COMMUNICATION DEGA SHQIPËRI, kanë vendosur kontakte me administratorin e tyre, personin nën hetim Adrian Shatku. Më pas në saj të detyrës së tyre publike në vitet 2014-2017, Ilir Metaj si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe Monika Kryemadhi si Deputete e Kuvendit të Shqipërisë, kanë ushtruar influencën e tyre me qëllim që kompanitë e Adrian Shatkut të futen në tregun shqiptar në dy drejtime, në fitimin e së drejtës së shtrimit e fibrave optike si dhe në tranzitimin ndërkombëtar të thirrjeve telefonike.

Në lidhje me fitimin e së drejtës, apo paisjen me autorizim për shtrimin e fibrave optike, personat nën hetim kanë ndikuar tek ish Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës Edmond Haxhinasto i cili ishte zgjedhur në këtë detyrë si përfaqësues i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim e drejtuar nga vetë Ilir Metaj, në mënyrë që Ministri fillimisht të heqë ekskluzivitetin e Kompanisë ATU sh.p.k. dhe me të njëjtën të drejtë/liçencë/autorizim të paiset dhe kompania Unifi e administruar nga Shatku. Personat nën hetim Metaj-Kryemadhi i kanë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për sigurimin e lejes përkatëse për ndërtimin e fibrës optike, UNIFI është paisur me leje zhvillimore, por për shkaqe financiare nuk ka arritur të kryejë punime në këtë drejtim.

Në lidhje me marrëveshjen e interkoneksionit/trasferim-tranzitimit të thirrjeve telefonike të lidhur midis Kompanisë UNIFI të drejtuar nga Shatku dhe Kompanisë të Telefonisë Celulare Vodafon, të dy personat nën hetim kanë ndikuar fillimisht tek Kryetari i AKEP Piro Xhixho, edhe ky i emëruar në këtë detyrë me vendim të Kuvendit të Shqipërisë të drejtuar nga Ilir Metaj, me propozim të Partisë Politike Lëvizja Socialiste për Integrim të drejtuar nga Ilir Metaj, dhe më pas drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet shtetasit Thodhori Çami, duke ushtruar influencën e tyre politike dhe institucionale kanë ndikuar tek CEO/Drejtori i Kompanisë së Telefonisë Celulare Vodafone, me qëllim realizimin e marrëveshjes.

Si rezultat i kësaj veprimtarie, dhe ushtrimit abuziv të pushtetit politik që ata kanë patur, kanë përfutur nga shtetasi Adrian Shatku dhe Kompania UNIFI, të ardhura të konsiderueshme duke përfshirë përqindjet e fitimit, si dhe paisjen nga Adrian Shatku disa herë me karta krediti. E tillë është karta e kreditit Amerikan Expres në emër të Monika Kryemadhit që rezultoi nga ekspertimi kompjuterik i

aparatit telefonik të sekuestruar gjatë kontrollit të banesës së shtetases Fatime Kryemadhi, kartë e cila nuk është deklaruar nga Monika në Deklaratat Periodike të pasurisë, për vetë faktin se shumat monetare të konsumuara janë burim i veprimtarisë së korrupsionit. Të tilla janë dhe përfitimet e tjera të Monikës të siguruara nga Adrian Shatku, sikurse është shuma prej 12.000 USD e shpenzuar me kartën e kreditit të Adrian Shatkun në butikun Maccapani në San Marino në datën 25 Shtator 2014, shumë e cila nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë as si e ardhur as si shpenzim, shuma prej 3.200 POUND të paguar për regjistrimin e Bora Metaj në kolegji nëpërmjet kartës Visa të tij me nr. 4147-2021-1387-5957, shuma prej 1.183.104 lekë e paguar prej Adrian Shatkut në Hotel Rogner për shpenzime të akomodimit të John Moreira dhe përfaqësuesve/punonjësve të tjerë të JPM Strategic Solutions, ndërkohë që është vërtetuar që ata kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë, për të ofruar shërbime konsulence ku përfitues është Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Ilir Metaj.

Pas caktimit dhe ekzekutimit të masave të sigurimit, në zbatim të letërporosisë nr. L 201 të vitit 2024, Departamenti i Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka përcjellë të dhënat e siguruara nga kompania American Express, për kartat e kreditit në emër të Adrian Shatku. Nga informacioni dhe aktet e përcjella në ekzekutim të letërporosisë, rezulton se ky shtetas ka patur në përdorim kartën Amex Busines Centurion me nr.xxxx xxxxx3-31009; Amex Busines Centurion me nr.xxxx xxxxx1-69001 dhe kartën e kreditit Amex Corporate Platinum me nr. XXXX XXXXX9-97005.

Nga të dhënat e përcjella nga Kompania Amex rezulton se në datën 07 Dhjetor 2014, është bërë një pagesë në vlerën 2500 USD si tarifë antarësimi e Monika Kryemadhit në American Express. Në pasqyrën përmbledhëse për të dhënat e llogarisë së kartës Amex që përfundon **me numrat 3-31009**, në emër të Adrian Shatkut, pasqyrohen shpenzimet edhe të një karte AMEX Centurion (shtojcë) **me numra të fundit 3-31017**. Në pasqyrën analitike të blerjeve që janë kryer në muajin Dhjetor 2014 *rezulton se mbajtëse e kartës AMEX Centurion me numra të fundit 3-31017, është shtetasja Monika Kryemadhi.* Limiti i shpenzimeve mujore për këtë kartë është 100,000 USD. Kjo kartë është përdorur për here të parë në datën 6 Dhjetor 2014 për blerje në dyqanet Selfridges në Londër dhe shpenzimi i fundit me këtë kartë është bërë në datën 19 Nëntor 2017 për pagesa në hotelin Berkeley Londër. Shpenzimet e kryera nga Monika Kryemadhi me kartën American Express Centurion me numër XXXX XXXXX3-31017, për periudhën Dhjetor 2014- Nëntor 2017 kapin vlerën 234,677.83 USD. Sipas përshkrimit të llojit të shërbimit, pagesat e kryera nga Monika Kryemadhi janë kryesisht për blerje në dyqanet e veshjeve në Londër, Vjenë, Las Vegas, Beverly Hills; pagesa të qëndrimit në hotel në Londër, Neë York dhe Las Vegas si dhe bileta avjoni për udhëtimet.

Nga Kqyrja e të dhënave të sistemit TIMS, rezulton se ë të gjitha rastet në të cilat kjo kartë është përdorur jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë, e pandehura Monika Kryemadhi ka qenë jashtë vendit.

Sa më sipër, rezulton e provuar se Monika Kryemadhi ka përdorur kartën e kreditit AMEX Centurion (shtojcë e kartës primare të Adrian Shatkut) me numër XXXX XXXXX3-31017, me limit të shpenzimeve mujore në vlerën 100,000 USD. Shpenzimet e kryera nga Monika Kryemadhi me kartën American Express Centurion me numër XXXX XXXXX3-31017, për periudhën Dhjetor 2014- Nentor 2017 kapin vlerën 234,677.83 USD.

Po kështu rezulton e provuar se personat nën hetim Metaj-Kryemadhi, kanë përfituar dhe një % të fitimit që Kompania Unifi Holding INC, ka siguruar si rezultat i marrëveshjes së interkoneksionit të thirrjeve telefonike të lidhur me Kompaninë Telefonike Celulare Vodafon, pikërisht në saj të influencës dhe ndikimit të Ilir Metaj e Monika Kryemadhi. Ky fakt rezulton nga komunikimet që Monika ka me Shatkun ku i drejtohet me shprehjet *“ne”*, *“leja Dhorit dhe të miat”*, si dhe nga fakti që Monika disa herë ka kërkuar të dijë sasinë e minutave të tranzituara, fitimin e realizuar nga shoqëria, shpërndarjen e tij si dhe pjesët takuese. Po ashtu ajo bën verifikime nëse bashkëortaku i fshehur Theodhori ja ka me hile.

Monika Kryemadhi, është e përfshirë drejtpërdrejtë në takime me zyrtarët Haxhinasto, Xhixho, CEO-n e Vodafone, shtetasin Theodhori si dhe ka mbajtur kontakte të vazhdueshme telefonike me Adrian Shatkun ku kanë diskutuar çdo hap që duhet të ndërmerrnin për realizimin e kontratave dhe aktiviteteve fitimprurëse të kompanisë.

I pandheuri Ilir Metaj ka luajtur rol aktiv në të gjitha përpjekjet që Adrian Shatku ka bërë për të siguruar lehtësira në aktivitetin e tij në Shqipëri. Nga bisedat e Monikës me Adrianin, del se Iliri ka biseduar me Damian Gjikhurin dhe Edmond Haxhinaston të cilët i ka thirrur në zyrën e tij.

I pandehuri Ilir Metaj në të paktën dy raste, ka biseduar me Thodhoriun për vonesat që Vodafoni i kishte shkaktuar nënshkrimit të marrëveshjes me Unifi Holdings Inc, Dega Shqipëri, madje ai ka kërkuar të shohë vetë personalisht dokumentacionin dhe kontratën.

Adrian Shatku është personi i besuar i Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit, dhe sipas deklaramentit të Fatime Kryemadhit, edhe kushëri i largët i tyre. Ky shtetas dyshohet se është takuar me ndërmjetësimin e Ilir Metës me ministrat e Energjisë dhe Ekonomisë të Mbretërisë së Marokut në datën 31 Tetor 2014, ditë kur Ilir Meta zhvillonte takim zyrtar në Marok. Sipas mesazheve që Monika i ka dërguar Adrianit, Ilir Meta i kishte thënë bashkëshortes se *tij se këtë vizitë/udhëtim e ka bërë vetëm për Adrianin*. Monika i ka shkruajtur Adrianit se *“ po të duash për të vajtur (në Marok) dhe*

nëse të duhet ndonjë takim me ndonjë ministër-më tha Iliri”. Lidhur me këtë, Adriani i është përgjigjur se ai do të shkojë dhe se “...takimin me PM e bëj unë..takojmë edhe ministat e energjise dhe telekomunikacionit”.

Adriani i ka kërkuar Monikës që të organizojë mundësisht në shtëpi takimin midis Ilir Metës dhe ambasadorit të Katarit dhe investitorit të CIT. “*Qatari ambasador dhe Ahmed dhe BIN Saad...(Presantimin e ke në email) po munde edhe ne shtepi më mirë..janë miq që duhen.*”) Bin Saad është kryetar i grupit GSSG Holding.

Nga ana tjetër Adrian Shatku ka mbajtur lidhjet midis John Moreira, drejtues ekzekutiv i JPM Strategic Solution dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, ku në të paktën dy raste është dokumentuar se ka ndërmjetësuar ardhjen në Shqipëri të John Moreira dhe dy personave të tjerë të quajtur Patrik dhe Kate. John Moreira ka kryer takime strategjike me Ministrat e LSI-së në vitin 2014, ka bërë sondazhe për zgjedhjet lokale të vitit 2015 për LSI-në ndërsa Patrik dhe Kate kanë trajnuar të rinjtë e LRI-së në kampin e Jalës. Adriani ka biseduar edhe me një person i quajtur Ali Soufan, drejtor ekzekutiv i Soufan Group, të cilit i ka kërkuar në emër të Ilir Metës nëse ai dhe ministri i financave të Katarit janë gati për tu takuar me Metën. Gjithashtu i ka kërkuar këtij personi që të sigurojë edhe një pajisje antipërgjimi për Ilir Metën (email i dates 13 Tetor 2014).

Pretendimi i të pandehurit Ilir Metaj se ai nuk ka asnjë lidhje me Adrian Shatkun dhe se nuk ka qenë asnjëherë afër me të, rrezohet edhe nga deklarimi i shtetasit Eriol Brahimllari, i cili ka deklaruar se “*Adriani kishte një marrëdhënie të konsoliduar me drejtuesit e LSI-së para se unë të angazhohesha në këtë parti. Adrian Shatku, në dijeninë time, ishte një biznesmen shqiptaro-amerikan që kishte një biznes të suksesshëm në Amerikë, dhe që ndihmonte LSI-në me eksperiencën dhe ekspertizën e vet.*”

Eriol Brahimllari, pyetjes sa herë ishin takuar me Adrian Shatkun dhe kush ka qenë tjetër i pranishëm gjatë udhëtimeve në Amerikë, me kryetarin e Kuvendit, Z. Ilir Metaj, i është përgjigjur se “*Une kam qenë i pranishëm në të paktën më shumë se nje takim me Adrian Shatkun. Prania ime në takimet që Kryetari i Kuvendit, Ilir Metaj ka zhvilluar me Adrian Shatkun dhe persona të tjerë, ka qenë sipas kërkesës së Kryetarit të Kuvendit.*”.

Të dhënat e sipërcituara, përforcojnë argumentet në lidhje me përfitimet nga veprimtaria e kundërligjshme e korrupsionit e të pandehurit Ilir Metaj dhe të pandehurës Monika Kryemadhi, dhe lidhjet e tyre të ngushta dhe konstante me shtetasin Adrian Shatku.

I pandehuri Ilir Metaj, në saj të detyrës si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë por edhe si Kryetar i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, nëpërmjet ndikimit të ushtruar tek Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, personi

nën hetim Piro Xhixho, i zgjedhur nga Kuvendi në kohën e drejtimit nga Ilir Metaj, me propozim të Partisë së drejtuar nga Ilir Metaj, si dhe së bashku me bashkëshorten e tij, personin tjetër nën hetim Monika Kryemadhi, kanë ushtruar ndikim tek Drejtori i Kompanisë së Telefonisë Celulare Vodafon, në mënyrë që të lidhej kontrata midis Vodafon dhe Unifi Communication Inc, administrator i të cilës ka qenë Adrian Shatku, me qëllim tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare/interkoneksionin. Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie, i pandehuri Ilir Metaj në bashkëpunim me të pandehurën Monika Kryemadhi, njëkohësisht edhe bashkëshorte e tij, kanë përfituar jo vetëm nga fitimet mujore të kompanisë, por kanë përfituar edhe një kartë krediti American Express me limit mujor 100.000 dollarë, dhe shpenzime të tjera për familjen të kryera nga Adrian Shatku.

- III. I pandehuri Ilir Metaj dhe e pandehura Monika Kryemadhi, në këmbim të ndikimit të paligjshëm pranë drejtuesve të institucioneve publike të emëruar në detyrë si përfaqësues të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në favor të shtetasit Samir Manes, kanë pranuar një premtim për të përfituar një vilë në residencën Rolling Hills në vitin 2014, vilë e cila është identifikuar me nr. 103. Kjo vilë dhe punimet që janë kryer në të gjatë vitit 2014, nuk janë deklaruar nga të pandehurit Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi si pasuri qoftë edhe e përkohshme apo si investim i përkohshëm i kryer prej tyre, duke çuar në konkluzionin se kjo pasuri do të përfitohej, për shkak të veprimtarisë së paligjshme të korrupsionit të kryer nga Monika Kryemadhi dhe Ilir Metaj. Konkluzioni se ata e kanë përfituar këtë vilë, qoftë edhe përkohësisht si vepër penale korruptive, rezulton nga fakti se ata kanë hequr dorë prej saj pasi është marrë vesh ndër të tjera dhe nga Ambasadori Grek në Tiranë, por dhe nga fakti që gjatë kohës që është arritur marrëveshja korruptive ajo ka filluar të ekzekutohet për shkak të faktit se çifti kanë kryer dhe punime të brendshme të vilës.

Veprimtaria e paligjshme e Monika Kryemadhit dhe Ilir Metës konsiston në miratimin e ligjit nr. 134/2014 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10304 datë 15 Korrik 2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, sipas interesave ekonomike të kompanisë “Albchrome”, pronar i të cilës ishte shtetasi Samir Mane, ndërhyrjen e paligjshme në favor të Samir Manes te Zyra e Përmbartimit, dhe konkretisht përmbartuesi Sajmir Xhuglini, ndërhyrja e paligjshme e Monika Kryemadhit dhe Ilir Metës te kryetari i AKEP, Piro Xhixho në favor të kompanisë Plus Communications ku Samir Mane ishte aksioner.*

- IV. I pandehur Ilir Metaj me cilësinë e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, ka konsumuar veprën penale *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”* parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Me këtë cilësi, i pandehuri Ilir Metaj, ka ndërmarrë veprime aktive kriminale, me qëllim fshehjen e natyrës së vërtetë, origjinës dhe burimit të fondeve të cilat janë përdorur për të financuar kontratat e lobimit me kompaninë GSIS LLC, duke ditur që këto para janë produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

I pandehuri Ilir Metaj, pikërisht në saj të pozicionit të tij publik, në drejtimin e institucioneve të shtetit, dhe njëkohësisht të Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim është përfshirë në veprimtari korruptive, sikurse u përmend dhe në tri faktet e përshkruara më sipër të cilat kanë sjellë përfitime të paligjshme, dhe është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai është munduar që të fshehtë këtë përfitim apo një pjesë të tij.

Ka qenë pikërisht personi i pandehuri Ilir Metaj, me cilësinë e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim që ka përfituar shërbimet e ofruara nga kompanitë e lobimit, dhe në shumë raste ka qenë vetë pjesëmarrës në Shtetet e Bashkuara në takimet e organizuara, duke vërtetuar në këtë mënyrë dijeninë e tij për ekzistencën jo vetëm të marrëdhënies juridike por dhe të ekzekutimit të saj nëpërmjet shërbimeve të përfituara.

Në funksion të dokumentimit veprës penale të *“Pastrimi i Produkteve të Veprës Penale ose Veprimtarisë Kriminale”* të kryer prej të pandehurit Ilir Metaj, në lidhje me kontratat e lobimit, janë administruar edhe prova të reja shkrese.

Me shkresën nr. 18465 Prot datë 12 Qershor 2025, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka përcjellë informacionin mbi vizitat e kryera në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjatë periudhës 2016-2017.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Ambasadorja e Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka informuar Kabinetin e Ministrit, në lidhje me vizitën e kryer nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Z. Ilir Meta, në datat 9-17 Maj 2016 dhe 4-8 Qershor 2016.

Në informacion përmendet se Z. Ilir Meta është takuar në datat 9-17 Maj 2016, me Zv/Ndihmës Prokurorin e Përgjithshëm Z. Bruce Sëartz, me temë reformën në drejtësi ku Z. Ilir Metaj është prezantuar si Kryetar i Parlamentit Shqiptar por edhe si Kryetar i LSI-së. Gjithashtu takime ka zhvilluar edhe me Zv/Ndihmës Sekretarin Hot Yë, Drejtoreshën për Ballkanin dhe Kaukazin, Znj. Victoria Teylor, Administratorin e Shërbimit të Jashtëm Bujqësor Z. Philip C Karsting, ku Z. Karsting ishte shprehur se mirëpriste një vizitë të Ministrit të Bujqësisë dhe takime në nivel ekspertësh, me Kryetarin e Komitetit të Sigurisë Kombëtare në Kongres, Z. Mark McCau dhe kongresmenin Peter Session, kongresmenin Ed Royce, kongresmenin John Katko, dhe drejtuesin e nënkomitetit për Bujqësinë, kongresmenin Rober Aderholt.

Në informacionin e dërguar nga Ambasadorja Floreta Faber, lidhur me vizitën e Kryetarit të Parlamentit Shqiptar në datat 4-8 Qershor, rezulton se Z. Ilir Metaj ishte

i ftuar nga Këshilli Amerikan Hebre dhe midis takimeve të zhvilluara nga Z. Ilir Metaj, përmendet edhe takimi me Ndihmës Sekretarin e Shtetit për Byronë e Luftës kundër Drogave dhe Rendit Ligjor, Z. Eilliam Brëonfield me temë Reformën në Drejtësi, si dhe takimi në departamentin e Cyber Security në Universitetin George Uashington si dhe takime të tjera.

Në deklaratën raportuese të kompanisë GSIS për periudhën e raportimit 1 Janar 2016 deri më 31 Korrik 2016, kjo kompani ka raportuar se ka kryer aktivitet politik për llogari të LSI-së, duke këshilluar LSI-në në marrëdhëniet e saj me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara dhe drejtuesit politikë, ndërsa Shqipëria bën progres me reformën kushtetuese dhe modernizimin e ekonomisë së saj, identifikuar me dokumentin nr. 1 (një) bashkëlidhur. Në dokumenton nr. 1 (një) të bashkëlidhur është përshkruar gjithë aktiviteti politik që GSIS LLC ka zhvilluar për Kryetarin Meta, midis të cilave edhe pjesa më e madhe e takimeve të përshkruara në informacionet e Ambasadores Floreta Faber.

Me shkresën Nr. 18464 Prot, datë 28 Maj 2025, i është kërkuar Kuvendit të Shqipërisë informacion mbi vizitat e Kryetarit të Kuvendit, Z. Ilir Metaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për periudhën 2016-2017, ftesat mbi të cilat janë organizuar vizitat, përbërjen e delegacioni, programin e takimeve të planifikuara dhe takimet e realizuara. Me shkresën Nr. 1686/1 Prot. date 05 Qershor 2025, Kuvendi i Shqipërisë ka kthyer përgjigje të plotë mbi delegacionet që kanë shoqëruar Kryetarin e Kuvendit, por nuk kanë dërguar përgjigje të plotë mbi ftesat e pranuar, programin e takimeve të planifikuara dhe takimet e realizuara.

Është vërtetuar që në marrëdhënien që Lëvizja Socialite për Integrim ka me Global Security& Inovative Strateges janë deklaruar shpenzime 93.761 USD, ndërkohë që është vërtetuar se Global Security& Inovative Strateges ka përfituar nga kjo marrëdhënie 463.546,26 USD apo 369.785 USD më shumë, se shuma e deklaruar në Shqipëri.

Fakti që, në lidhje me raportin me G.S.I.S. një pjesë e vogël e shpenzimeve janë paguar nëpërmjet llogarive bankare dhe pjesa tjetër nuk është paguar nga llogari të njohura e të regjistruara, ndërkohë që është vërtetuar se vetë Ilir Metaj është përfshirë në marrëdhënie korruptive para kësaj kohe, si dhe fakti që ai është përfitues i drejtpërdrejtë i shërbimeve, arrihet në konkluzionin se ai ka fshehur natyrën e vërtetë të burimit, si dhe ka marrë pjesë në zhvendosjen e shumave monetare jashtë sistemit bankar, duke i shpenzuar këto shuma për shërbimet e përfituara. Përderisa vetëm një pjesë e shpenzimeve në lidhje me raportin me G.S.I.S. janë transferuar në rrugë të ligjshme bankare, tregon jo vetëm që janë para të siguruara në mënyrë të paligjshme, por dhe dijeninë e qëllimin e tij për të mbuluar origjinën, transferimin si dhe mbulimin e natyrës së vërtetë të të ardhurave.

Fshehja e shpenzimeve të kryera në zbatim të kontratës së këshillimit të lidhur me Global Security& Inovative Strategies, ka filluar që në gjashtëmuorin e parë të vitit 2016 pasi njëra nga katër shumat e përfituara nga G.S.I.S-ja nuk është kryer nga llogaritë bankare të LSI-së.

Fakti që fshehja e pagesave ka filluar që në fillimet e marrëdhënies LSI-G.S.I.S, hedh poshtë pretendimin e të pandehurit Ilir Metaj se ai nuk ka dijeni në lidhje raportimet e bëra nga kompania.

Ky konkluzion, është dhe në harmoni me faktin, personi nën hetim Ilir Metaj me cilësinë e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, e ka ditur që duhet ti deklarojnë këto shuma monetare pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, dhe nuk e ka deklaruar as si financim as si shpenzim, duke e fshehur atë.

Ligji për financimin e partive politike në nenin 15/1 pika 2 përcakton se : *“Financimi i partive politike udhëhiqet nga parimi i transparencës. Të dhënat për burimet financiare të partive si dhe për shpenzimet e tyre, publikohen kurdoherë”.*

Në nenin 23/1, të ligjit *“Për financimin e partive politike”* përcaktohet se;

- Çdo parti politike duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çdo rast, dhuruesi, në kohën e dhurimit, nënshkruan detyrimisht një deklaratë dhurimi, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e personave, që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhen kurdoherë publike.
- Dhurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga partia politike.
-
- *Ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.*
- Çdo shpenzim i kryer nga partia politike kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

Nga hetimi është vërtetuar se egziston një lidhje interesash ekonomike dhe transaksione bankare midis kompanisë B.SK. shpk, kompanisë Unifi Communications Inc me president Adrian Shatkun, Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Ilir Metaj e Monika Kryemadhi.

Bazuar në faktin se:

1. Partia LSI për vitin 2016-2017 ka kryer pagesa të padeklaruara në shumën **369.785 USD për të kryer pagesat për shërbimet e ofruara nga kompania lobuese GSIS LLC.**
2. Burimi i fondeve që kanë financuar kontratat e lobimit dhe konsulencës të partisë LSI, nuk është deklaruar sipas ligjit,
3. Adrian Shatku dhe kompania Unifi Communication Inc kanë kryer pagesa në shumën 253.285 lekë për llogari të partisë LSI me qëllim mbulimin e shpenzimeve që lidhen me ekzekutimin e kontratës së këshillimit që Lëvizja Socialiste për Integrim ka lidhur me kompaninë Global Security& Innovative Strategies I.I.C..
4. Ema Çoku i ka transferuar Adrian Shatkut dhe Unifi Communication Inc shumën 220,000 dollarë nga të cilat 100,000 USD janë derdhje cash të copëzuara brenda një dite në të njëjtën llogari nga persona pa të ardhura (punonjëse të B.S.K shpk).
5. Kompania B.S.K dhe vetë Ema Çoku, kanë paguar shuma nga 3,000 Euro; 4,465 Euro; 10,000 Euro; 867,000 lekë; 1,142,000 lekë deri në 4,100,000 lekë, *për aktivitete të LSI-së dhe të përfaqësuesve të kompanisë JPM Strategic Solutions LLC që kanë kryer aktivitetet në Shqipëri për llogari të LSI-së,*

arrihet në konkluzionin se Ilir Metaj me cilësinë e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, ka konsumuar veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Me këtë cilësi, personi nën hetim Ilir Metaj, ka ndërmarrë veprime aktive kriminale, me qëllim fshehjen e natyrës së vërtetë, origjinës dhe burimit të fondeve të cilat janë përdorur për të financuar kontratat e lobimit, duke ditur që këto para janë produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

Më konkretisht duke qenë se personi nën hetim Ilir Metaj, pikërisht në saj të pozicionit të tij publik, në drejtimin e institucioneve të shtetit, dhe njëkohësisht të Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim është përfshirë në veprimtari korruptive, sikurse rezultoi dhe në dy faktet e para të përshkruara më sipër të cilat kanë sjellë përfitime të paligjshme, ka të dhëna përtej dyshimit të arsyeshëm se ai është munduar që të fshehtë këtë përfitim apo një pjesë të tij.

Të tilla janë dhe marrëdhëniet e entitetit politik të drejtuar prej tij Lëvizja Socialiste për Integrim, me kompanitë Amerikane të Lobimit G.S.I.S.

Ka qenë pikërisht personi nën hetim Ilir Metaj, me cilësinë e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim që ka përfituar shërbimet e ofruara nga kompanitë e lobimit, dhe në shumë raste ka qenë vetë pjesëmarrës në Shtetet e

Bashkuara në takimet e organizuara, duke vërtetuar në këtë mënyrë dijeninë e tij për ekzistencën jo vetëm të marrëdhënies juridike por dhe të ekzekutimit të saj nëpërmjet shërbimeve të përfituara.

Është vërtetuar që në marrëdhënien që Lëvizja Socialite për Integrim ka me Global Security& Inovative Strategies janë deklaruar shpenzime 93.761 USD, ndërkohë që është vërtetuar se Global Security& Inovative Strategies ka përfituar nga kjo marrëdhënie 463.546,26 USD apo 369.785 USD më shumë, se shuma e deklaruar në Shqipëri.

Fakti që, në lidhje me raportin me G.S.I.S. një pjesë e vogël e shpenzimeve janë paguar nëpërmjet llogarive bankare dhe pjesa tjetër nuk është paguar nga llogari të njohura e të regjistruara, arriet në konkluzionin se ai ka fshehur natyrën e vërtetë të burimit, si dhe ka marrë pjesë në zhvendosjen e shumave monetare jashtë sistemit bankar, duke i shpenzuar këto shuma për shërbimet e përfituara. Përderisa vetëm një pjesë e shpenzimeve në lidhje me raportin me G.S.I.S. janë transferuar në rrugë të ligjshme bankare, tregon jo vetëm që janë para të siguruara në mënyrë të paligjshme, por dhe dijeninë e qëllimin e tij për të mbuluar origjinën, transferimin si dhe mbulimin e natyrës së vërtetë të të ardhurave.

Ky konkluzion, është dhe në harmoni me faktin, personi nën hetim Ilir Metaj me cilësinë e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, e ka ditur që duhet ti deklarojnë këto shuma monetare pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, dhe nuk e ka deklaruar as si financim as si shpenzim, duke e fshehur atë.

Në lidhje me marrëdhënien që Lëvizja Socialiste për Integrim ka patur me McKEON Group, nëpërmjet Dorelita Limited, në vijim të kërkesave tona, pas pretendimit të Z. Meta në seancën gjyqësore për verifikimin e kushteve për zbatimin e masës së sigurimit, Autoritetet Gjyqësore Amerikane me email-in e datës 15 Nëntor 2024 kanë informuar se pagesat për shërbimet e kontratës së lidhur midis Dorelita Limited dhe McCeon Group janë paguar nga kompania Taliadoros Audit Firm LTD dhe nuk është vërtetuar ndonjë lidhje midis pagagesa të kryera nga kjo kompani dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe Ilir Metës si Kryetar i saj.

A. HETIMET LIDHUR ME VEPRAT PENALE TË “PASTRIMIT TË PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE OSE VEPRIMTARISË KRIMINALE”, NË LIDHJE ME FAKTIN E BLERJES SË APARTAMENTIT DUBLEX NË ISH-BLLOK

Sikurse është sipërcituar, në funksion të hetimeve të bëra në lidhje me kallëzimin e shtetasve Halit Valteri e Idajet Beqiri, se personat nën hetim Metaj-

Kryemadhi, dhe persona të tjerë të lidhur me ta është bërë hetimi pasuror i këtyre personave, me fokus dokumentimin e shpenzimeve, mundësia për të përballuar shpenzimet e jetesës, duke përfshirë këtu dhe mundësinë e krijimit të pasurive e për rrjedhojë dhe transkasionet me pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, transkasionet financiare bankare dhe jo vetëm, etj. Po kështu në çdo rast, transaksionet financiare janë ballafaquar me deklaratat e pasurisë në vite, duke qenë se të dy personat nën hetim Ilir Metaj e Monika Kryemadhi kanë qenë subjekte të ligjit Nr. 1049 datë 10 Prill 2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve, dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.*

a. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasit Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi nuk kanë deklaruar gjendje të parave cash në vitin 2007, në vitin 2008 dhe në vitin 2009 për këtë arsye u bë verifikimi i llogarive bankare të tyre dhe familjarëve të afërt. Nga verifikimi i llogarisë bankare nr. 00000119835, monedha Euro, e shtetasit Monika Kryemadhi rezulton se në datën **08 dhe 9 Maj 2008** ka tërhequr nga overdrafti i llogarisë 50.000 Euro. Në datën **28 Maj 2008** ka derdhur cash **10.000 Euro** dhe **29 Korrik 2008** ka derdhur cash në llogari **41.000 Euro** *(nuk dihet origjina e këtyre parave pasi prezumohet se shuma e tërhequr nga overdrafti ka shërbyer për shpenzime pasi nuk rezulton që të jetë deklaruar si borxh ose hua, por duke qenë se vlera e overdraftit dhe depozitimet cash janë pak a shumë të përafërta, deri në këtë moment këto transaksione nuk e ndryshojnë situatën financiare e të pandehurve).*

b. Në datën 31 Tetor 2008, Monika ka tërhequr nga llogaria overdraft në vlerën 20.000 Euro. Ky overdraft është shlyer nga derdhja cash në vlerën 21.000 Euro që Fatime Kryemadhi ka bërë në këtë llogari në datën 18 Shkurt 2009. *(me këtë lëvizje, Monika rezulton që krijon të ardhura në shumën 20.000 EURO, ndërkohë që Fatimja nuk jep shpjegime në lidhje me burimin e të ardhurave prej 20.000 Euro me të cilat ka shlyer overdraftin e Monikës).*

c. Në 13 Mars 2009, Monika ka marrë kredi në vlerën 40.000 Euro të cilën e ka tërhequr cash po atë ditë. Në datën 07 Prill 2009, Monika ka tërhequr nga overdrafti 70.000 Euro cash, të cilin e ka likujduar në datën 22 Qershor 2009 duke marrë kredi në vlerën 115.000 Euro. Me diferencën e mbetur nga kredia 115.000 Euro, ka shlyer kredinë marrë në datën 13 Mars 2009. *(me këtë lëvizje gjendja financiare e llogarive bankare të Monikës, mbetet e pandryshuar, ndërkohë që ajo tashmë ka si detyrime ndaj bankës, në total shumën e kredisë prej 115.000 Euro.*

Në datën 23 Nëntor 2009, Fatime Kryemadhi ka derdhur cash në llogarinë e Monikës, shumën 70.000 Euro.

Në datën 26 Nëntor 2009, Monika ka marrë kredi në vlerën 45.000 Euro e cila së bashku me shumën 70.000 Euro të derdhur nga Fatimja, ka shërbyer për likuidimin e kredisë me vlerë 115.000 Euro.

Në datën 11 Dhjetor 2009, Fatimja ka derdhur cash në llogarinë e Monikës, shumë 47.000 Euro me të cilën Monika ka shlyer kredinë e marrë në datën 26 Nëntor 2009 në vlerën 45.000 Euro. *(Në këtë periudhë kohore, rezulton që Monika Kryemadhi nuk ka detyrime ndaj bankës, ndërkohë që llogaritë e saj janë kredituar nga Fatimja në total në shumë 138.000 Euro në shumën 21.000 Euro në datën 18 Shkurt 2009, 70.000 Euro në datën 23 Nëntor 2009, dhe 47.000 Euro në datën 11 Dhjetor 2009. Ndërkohë që në lidhje me këto shuma parashë që derdh në llogaritë e Monikës, Fatimja nuk përshkuan burimin).*

Si konkluzion, rezulton që në këtë periudhë kohore, Fatime Kryemadhi ka financuar për periudhën 18 Shkurt 2009-11 Dhjetor 2009, vajzën e saj Monika, me para cash në vlerën. Këto para nuk janë deklaruar si borxh apo hua nga shtetasja Monika Kryemadhi.

d. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive bankare të Fatime Kryemadhit, rezulton se kjo shtetase ka tërhequr nga llogaria nr. 082245 në bankën Emporiki, shumë 40.000 Euro në datën 29 Korrik 2009 dhe 10.000 Euro në datën 14 Tetor 2009, shuma të cilat mund të merren si gjendje deri në datën 23 Nëntor 2009. Burimi i krijimit të ketyre parave është kompania Agi Kons. Në fakt rezulton se Kompania AGI Kons ka kredituar në llogaritë e Fatimes shumë totale 100.000 Euro dhe më konkretisht 25 Korrik 2008 shuma prej 50.000 EURO si e ardhur nga kontrata premtim shitje, dhe në datën 13 Tetor 2009 shuma prej 50.000 Euro për anulimin e kontratës.

Nga sa më sipër dalim në përfundimin se shtetasja Fatime Kryemadhi, ka financuar llogarinë e Monika Kryemadhit me shumë 138.000 Euro nga të cilat për shumë 38.000 Euro nuk ka patur burim të ligjshëm të krijimit të tyre ndërsa diferenca ka patur burin kompaninë Agi Kons.

Në fakt në këtë periudhë kohore, Fatimja nuk ka burime të ligjshme, përveç shumës 38.000 (tridhjetë e tetëmijë) Euro dhe për pagesën e qirasë prej 3.000 (tre mijë) Euro në muaj për periudhën 01 Shkurt 2008-10 Mars 2010 (kur është nënshkruar kontrata e shitjes). Kontrata e qirasë ka zgjatur 25 Muaj, me një vlerë totale 75.000 Euro.

Pra si konkluzion, në total Fatimja ka mungese burimesh të ligjshme për të financuar shpenzimet deri në muajin Mars 2010, kohë kur janë blerë apartamentet dhe janë marrë kreditë një shumë rreth 113.000 EURO.

Shuma prej 138.000 Euro nuk është e pasqyruar në deklaratën e interesave private vjetore të subjekteve të deklarimit Monika Kryemadhi dhe Ilir Metaj të vitit 2009 si detyrim ndaj te tretëve. Gjithashtu rezulton se Monika Kryemadhi dhe Ilir Meta nuk kanë patur gjendje cash në vitin 2008-2009 pasi në rast se kjo gjendje cash

prej 200.000 Euro do të ishte realisht, atëhere Monika Kryemadhi nuk do të merrte kredi bankare.

e. Në datën 29 Mars 2010, në llogarinë nr. 219118 të Fatime Kryemadhit, disbursohet kredia në vlerën 335.000 Euro nga të cilat, Fatime Kryemadhi, sipas përshkrimit të transaksionit, ka tërhequr cash 200.000 Euro dhe transferon nga në llogarinë e Monikës shumën prej 100.000 Euro.

Në datën 30 Mars 2010, Fatimja tërheq cash edhe shumën 34.500 Euro dhe gjendja në llogarinë 219118 mbetet zero lekë, **ndërkohë që rezulton se tashmë kjo shtetase është debitore ndaj bankës për shkak të kredisë bankare në shumën 335.000 Euro.**

f. Nga kontrolli që iu bë në datën 21 Nëntor 2023, banesës së shtetases Fatime Kryemadhi, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale tre mandate bankare që vërtetonin se veprimet në arkë për tërheqjen cash nga llogaria nr. 219118, e Fatimes të shumës 200,000 Euro dhe 34,500 Euro, tërhequr në datën 29 Mars 2010 në datën 30 Mars 2010, janë kryer nga Mirvjen Nino dhe jo Fatime Kryemadhi.

Në deklarin e datës 4 Dhjetor 2023, shtetasi Mirvjen Nino deklaroi se *“tërheqja cash është bërë për të likuduar apartamentet që unë i shita Fatime Kryemadhit dhe Monika Kryemadhit me Ilir Metën.... Unë këto para i kam mbajtur për vete dhe vëllezrit, të cilat i kemi përdorur për nevoja tonat”*.

Në datën 28 Prill 2010, Fatimja e krediton këtë llogari me 10.000 Euro cash, dhe në datën 17 Maj 2010 transferon nga llogaria 216273 në lekë, në llogarinë 219118 në Euro, shumën 98.900 Euro, të cilën e ka depozituar cash me përshkrimin *“Kthim i shumës së tërhequr në datën 29 Mars 2010”*.

Në datën 26 Maj 2010 Fatime Kryemadhi transferon në llogarinë e Monikës, shumën 100.000 Euro. Këto para nuk janë ato të tërhequra në datën 29 Mars 2010 sikundër deklaroi Fatime Kryemadhi, **pasi kjo shumë është tërhequr nga Mirvjen Nino i cili i ka mbajtur për vete.**

a. Në datën 01 Qershor 2010 në llogarinë e Monika Kryemadhit disbursohet kredia në shumën 200.000 Euro dhe gjendja në llogari bëhet 400.883 Euro.

Në datën 01 Qershor 2010, nga llogaria e saj në Euro, Monika Kryemadhi transferon shumën 400.000 Euro, (në dy këste me nga 200.000 Euro), në llogarinë nr. 00000185779 të shtetasis Mirvjen Nino me përshkrim *“Likujdim kontrate shtëpie”*. Në vijim, nga llogaria është bërë kreditim dhe likujdim i interesave të kredisë 200.000 Euro.

Sa më sipër, si konkluzion rezulton se pasuria e llojit apartament me sipërfaqe prej 200 m2 ndodhur në rrugën “Vaso Pasho” nuk është financuar nga 200.000 Euro të cilat shtetasit Ilir Metaj/Monika Kryemadhi, kanë deklaruar se i kanë patur gjendje cash nga shitja e vilës në Qerret-Kavajë dhe 200.000 Euro kredi bankare, por burim i financimit janë 100.000 Euro nga kredia në vlerën 335.000 Euro e marrë në datën 29 Mars 2010 prej shtetases Fatime Kryemadhi, 100.000 Euro nga para të depozituara cash nga Fatime Kryemadhi në datën 17 Maj 2010, dhe 200.000 Euro kredi bankare. Kjo dhe për faktin se jo vetëm që nga Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi deri në këtë kohë nuk është deklaruar ndonjëherë gjendje cash, por dhe për faktin që në këtë periudhë kohore me gjithë transkasionet financiare të kryera, nuk ka asnjë depozitim cash nga Monika dhe Ilir Metaj. Ndërkohë që vetë Fatimja dhe një vit më parë rezulton se ka patur pamundësi financiare sipas pikës d.

b. Me procesverbalin e kqyrjes të datës 17 Janar 2023, është administruar kartela e pensionit e shtetases Fatime Kryemadhi nga e cila rezulton se kjo shtetase ka qenë e punësuar si infermiere me pagë neto 11.254 lekë në muajin e fundit para daljes në pension dhe në datën 26 Nëntor 2001, ka përfituar pension pleqërie. Totali i të ardhurave mujore së bashku me kompensimet për pensionisten Fatime Kryemadhi është llogaritur në 8316 lekë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. 362/2 Prot. datë 10 Korrik 2023, informon se shtetasja Fatime Sefedin Kryemadhi, nuk ka aktivitete privat të regjistruar në emrin e saj. Duke qenë se shtetasja Fatime Kryemadhi ka marrë kredi në shumën 335.000 Euro, një pjesë të të cilave ja ka kaluar Monikës e cila i ka përdorur për blerjen e banesës, u bë edhe verifikimi i llogarive bankare të saj për të identifikuar mënyrën e likuidimit të kësaj kredie.

Nga verifikimi rezultoi se në llogaritë bankare të saj janë depozituar cash dhe kredituar me transferim një shumë e madhe parash brenda një periudhe të shkurtër kohe dhe konkretisht:

Llogaria bankare nr. 001420200008830 në Emporiki Bank.

- 25 Korrik 2008, depozitë cash 50.000 Euro ardhur nga kontratë premtim shitje me Agi Kons.
- 13 Tetor 2009 depozite cash 50.000 Euro, kalim nga Agi Kons, anulim kontrate.¹

Llogaria nr. 00000216273 në Credins Bank.monedha Lek.

- 08 Mars 2010 arketim cash 8.500.000 leke (pa pershkrim për origjinën janë

¹ Këto shuma janë konfirmuar se janë kryer me transferim nga llogaria e kompanisë Agi Kons,

përdorur për blerjen e banesës nga Kozeta).

- 30 Mars 2010 arkëtim cash 1.800.000 lekë (pa përshkrim për origjinën)
- 10 Maj 2010 arkëton shumën 13.500.000 lekë me përshkrim *“Kthimi i shumës së tërhequr në datën 29 Mars 2010, por që është dokumentuar se atë shumë e ka përfituar Mirvjen Niño.*

Llogaria nr. 00000216268 në Credins Bank, monedha Euro.

- 08 Mars 2010 arketim cash 240.000 Euro (pa pershkrim për origjinën janë përdorur për blerjen e banesës nga Kozeta).
- 30 Mars 2010 arkëton cash 7.800 Euro

Llogaria nr. 00000219118 në Credins Bank, monedha Euro.

- 28 Mars 2010 arkëton 10.000 Euro cash;
- 05 Nëntor 2010, arkëton cash 42.000 Euro (pa përshkrim);
- 13 Nëntor 2010, arkëton cash 72.000 Euro me përshkrim “derdhje nga Agi Kons”;
- 30 Nëntor 2010, arkëton cash 30.000 Euro me përshkrim “derdhje nga Agi Kons”;
- 23 Dhjetor 2010, arkëton cash 2.400 Euro

Llogaria nr. 00000233624 në Credins Bank, monedha USD.

- **23 Qershor 2010 arketim cash 246.000 USD**, derdhje nga shitja e tokës Gentjan Sules (në lidhje me këtë shumë parashë rezulton se Fatimja nuk ka marrë ndonjëherë këtë shumë parashë nga Gentian Sula por vetëm 100.000 (njëqind mijë Euro në datat 25 Korrik 2008 dhe 13 Tetor 2009 nëpërmjet transferimit në llogarinë e saj bankare të shumave nga 50.000 EURO.
- 09 Mars 2010 arkëton cash Fatime Kryemadhi shumën 10.000 Euro (nuk tregohet burimi)

Nga transaksionet e mësipërme rezulton se Fatime Kryemadhi e ka likujduar kredinë 335.000 Euro brenda 8 muajsh me para cash të depozituara 246,000 USD (e konvertuar në 200.000 Euro) në muajin Qershor 2010, 144,000 Euro të depozituara cash në 05 Nëntor 2010- 30 Nëntor 2010 dhe 2,400 Euro të arkëtuara cash në muajin Dhjetor 2010, në llogarinë bankare në Euro nr. 00000219118 në Credins Bank (ndërkohë që sikurse u theksua këto të ardhura nuk mund të jenë nga Agi Kons dhe Gentjan Sula).

Nga hetimi ka rezultuar se me kontratën Nr. 1205 Rep, Nr. 334 Kol. datë 10

Mars 2010, shtetasja Kozeta Fino ia ka shitur pasurinë 3/64+8-1, me sipërfaqe 183 m2, shtetases Fatime Kryemadhi për vlerën 32,025,000 lekë, **të likujduara jashtë zyrës noteriale.** *(Kursi i këmbimit të Euros me lekun në datën 10 Mars 2010 ka qenë 1 x 139.3 dhe shumë 310.000 Euro që Fatime Kryemadhi ka transferuar në llogarinë bankare të Kozeta Finos, konvertohet në 43.183.000 lekë).*

Gjithashtu rezulton se në datën 31 Mars 2010, Fatimja ka paguar edhe 2.955.000 lekë si tatim për blerjen e pronës së mësipërme, e vertetuar nga mandati bankar që ndodhet në referencën Nr. 13472, datë 30 Prill 2010, ndërkohë që detyrimin e pagimit të tatimit e ka pala shitëse. Në total rezulton se Fatime Kryemadhi ka shpenzuar për blerjen e apartamentit nga Kozeta Fino, shumën prej 46.138.000 lekë së bashku me tatimin.

Nga sa më sipër, arrihet në konkluzionin se shtetasja Fatime Kryemadhi në datën 08 Mars 2010 ka depozituar në formë cash në dy llogari bankare në Credins Bank, shumën 8.500.000 lekë *(i ka konvertuar po atë ditë në shumën 60.000 Euro)* si dhe shumën 240.000 Euro. Këto shuma pasi i ka bashkuar në një llogari bankare (000002162680 Credins Bank) në datën 10 Mars 2010 i ka tërhequr cash. Në të njëjtën ditë, shumën prej 300.000 Euro e ka depozituar cash në llogarinë bankare nr.00082245, në Emporiki Bank. Pasi ka depozituar edhe 10.000 Euro të tjera cash në këtë llogari, shumën prej 310.000 Euro i ka transferuar në llogarinë e shtetases Kozeta Fino për të likujduar banesën që kjo e fundit i ka shitur. *Burimi i shumës prej 310.000 Euro nuk është deklaruar në momentin e depozitimit cash, nga shtetasja Fatime Kryemadhi dhe burimi i krijimit të këtyre parave është i panjohur.*

Nga hetimi ka rezultuar se qëllimi i kredisë në vlerën 335,000 Euro, ka qenë blerja nga shtetasit Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi e apartamentit me nr. pasurie 3/64+1-9, kati i dytë i apartamentit dubleks, pasi kati i parë i këtij apartamenti ishte likujduar më parë nga Fatimja për 310,000 Euro. Nga hetimi është vërtetuar se apartamenti tip dubleks i regjistruar në ZVRPP Tiranë me numrat e pasurisë 3/64+1-8 dhe 3/64+1-9, është blerë nga shtetasit Ilir Metaj, Monika Kryemadhi dhe Fatime Kryemadhi prej pronarit de facto, shtetasit Mirvjen Nino.

Vlera e apartamenteve dubleks të lartë përmendur e regjistruar në dy pasuri me Nr. 3/64+1-8 dhe 3/64+1-9 e paguar nëpërmjet bankës nga blerësit është 944,000 Euro, e cila përshin 310,000 Euro të transferuara nga llogaria e Fatimes në llogarinë e Kozeta Finos, 234,000 Euro të tërhequra cash prej Mirvjen Ninos nga llogaria e Fatimes (pagesë në dorë e padeklaruar zyrtarisht) dhe 400,000 Euro të paguara nga Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi, burimi i të cilave është shpjeguar më lartë. Kjo shumë nuk përputhet me vlerën e deklaruar në kontratat e shitjes prej shtetasve Ilir Metaj, Monika Kryemadhi dhe Fatime Kryemadhi e cila në total shkon në vlerën 630,000 Euro *(sipas vlerës së kontratave).*

Vlera e deklaruar në kontratën e shitjes prej 32,050,000 lekë konvertohet me kursin e asaj dite në 230,000 Euro, në fakt është më e lartë është 310.000 EURO, dhe kjo rezulton nga transferta bankare midis llogarive, dhe ka një diferencë prej 314,000 Euro e cila nuk është deklaruar nga blerësit.

Shtetasja Fatime Kryemadhi, pasi është pyetur lidhur me burimin e shumës 246.000 USD që kishte deklaruar në bankë se i kishte shitur tokën Gentian Sulës, deklaroi se nuk mbante mend ti kishte shitur tokë këtij shtetasi por do të bënte verifikimet në bankë dhe do të përgjigjej në një moment tjetër.

Në datën 11 Qershor 2024, Fatime Kryemadhi pas pyetjes së saj në funksion të këtij procesi, i ka përcjelle organit procedues deklaratën noteriale nr. 1846 Rep, nr. 897 Kol, datë 22 Maj 2024, nëpërmjet të cilës rezulton se Ema Çoku deklaron se në fillim të vitit 2010, i ka dhënë Fatime Kryemadhit, hua shumën 220.000 Euro. Kjo deklaratë jo vetëm që është e pabesueshme për shkak të faktit se është përpiluar për tu përdorur në këtë proces, dhe për të "përmbysur barrën e provës", por dhe për faktin se Ema Çoku gjatë gjithë kohës edhe në vitet në fjalë, ka qenë vetë debitore pranë bankave, nëpërmjet kredive bankare. Po kështu dhe nga kqyrja e bilanceve të kompanisë B.S.K. në këto vite, rezulton një fitim neto rreth 700.000-1.700.000 lekë për këto vite.

Në periudhën Shkurt – Dhjetor 2009, shtetasja Monika Kryemadhi është financuar nga Fatime Kryemadhi në vlerën 138.000 Euro të cilat janë përdorur për të shlyer kreditë dhe overdraftin që Monika Kryemadhi ka marrë në këtë periudhë në Bankën Credins. Veprimet bankare që Monika Kryemadhi ka kryer në llogarinë e saj nr. 119835 në Euro janë kryer si vijon:

- Në datën 06 Maj 2008 i disbursohet kredia nr. 6659 në vlerën 50.000 Euro të cilat i tërheq në datën 08 dhe 09 Qershor 2008;
- Në datën 28 Korrik 2008 arkëton 10.000 Euro dhe në datën 29 Korrik arkëton 41.080 Euro për mbyllje overdrafti. Në total ka paguar 1048 Euro interesa.
- Në datën 31 Tetor 2008, ka marrë kredi nr. 6659/002 në shumën 20.000 Euro të cilat i ka tërhequr cash. Në datën 19 Nëntor 2008, Monika ka kredituar llogarinë me 200 Euro të cilat kanë shërbyer për të paguar komision disbursim kredie. Në datën 31 Dhjetor 2008 gjithashtu janë paguar edhe 343 Euro interesa debitore.

Këto kredi nuk janë deklaruar nga ana e Monika Kryemadhit në formularin e deklarimit të interesave private vjetore të vitit 2008.

- Në datën 18 Shkurt 2009 llogaria nr. 119835 të Monika Kryemadhit është

- kredituar me derdhje cash nga Fatime Kryemadhi në shumën 21.000 Euro e cila përdorur për të likujduar kredinë e marrë nr. 6659/002.
- Në datën 13 Mars 2009, Monika Kryemadhi ka marrë përsëri një kredi në shumën 40.000 Euro dhe në datën 07 Prill 2009 ka tërhequr nga overdrafti edhe 70.000 Euro. Në datën 22 Qershor 2009 ka marrë përsëri kredi në vlerën 115.000 Euro, ka paguar interesa debitore 3.039 Euro, ka paguar 40.936 Euro si kështu kredie së bashku me interes dhe kamatvonesë, nga paratë e kredisë (115.000 Euro) për të likujduar kredinë e marrë në 13 Mars 2009 dhe i ka mbetur pa likujduar kredia e re prej 115.000 Euro së bashku me interesat.
 - Në datën 23 Nëntor 2009 Fatime Kryemadhi ka derdhur cash shumën 70.000 Euro. Në datën 26 Nëntor 2009, Monika merr përsëri kredi në shumën prej 45.800 Euro dhe gjendja në llogari bëhet 115.811 Euro. Në datën 23 Nëntor 2009, Monika paguan kështu e kredisë në shumën 119.300 Euro për të likujduar kredinë prej 115.000 Euro *(që ka marrë në datën së bashku me interesat)* dhe i mbetet për të likujduar vetëm kredia e fundit e datës 23 Nëntor 2009 në vlerën 45.800 Euro së bashku me interesat.
 - Në datën 11 Dhjetor 2009, Fatime Kryemadhi derdh cash në llogarinë e Monikës, shumën 47.000 Euro me të cilën Monika bën pagesën e kështu të kredisë në vlerën 45.852 Euro të marrë në datën 26 Nëntor 2009.

Edhe këto kredi të marra për vitin 2009 si dhe likujtimi i tyre nga paratë cash të Fatime Kryemadhit, nuk janë deklaruar nga ana e Monika Kryemadhit dhe Ilir Metës në formularin e deklarimit të interesave private vjetore të vitit 2009. Gjithsesi ky fakt nuk ndikon në thelbin e analizës financiare të Metaj-Kryemadhi në këtë periudhë kohore, por konstatohet pamundësia financiare e Fatimes për të shlyer kreditë e tyre.

Një pjesë e parave që Monika ka siguruar nëpërmjet kredive dyshohet se janë shpenzuar për arredimin e apartamentit dubleks, ndodhur në rrugën "Vaso Pasha". Këto dyshime bazohen edhe në deklarimin e datës 02 Mars 2023, të shtetasit Mirvjen Nino i cili ka thënë se "Nga sa më ka thënë vëllai, pronarët e rinj bënë punime të tjera ndërtimi si shtrim me pllaka të reja, termoizolim të jashtëm, parket dhe oxhak. Vëllai qëndronte shume me Monikën dhe ka ndjekur edhe punimet që janë bërë brenda duke nxjerrë 4 dhoma gjumi. Nga sa kam dijeni unë e kam me të dëgjuar që më vonë Monika dhe Iliri kanë blerë edhe një apartament që ndodhej poshtë Kozetës. Të gjitha i kam me të dëgjuar pasi në vitin 2012 unë kam ndërprerë cdo marrëdhënie pasi kam ikur në Angli."

U bë verifikimi i deklaratës se interesave private periodike/ vjetore të Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi të vitit 2009. Sipas deklarimit në formularin e deklaratës periodike/vjetore për vitin 2009, rezulton se shtetasi Ilir Meta ka banuar në rrugën

Teodor Keko dhe pastaj në rrugën *Rruga Vaso Pasha, pallati i Fratarit, kati 5*. Adresa në rrugën Teodor Keko i korespondon adresës së apartamentit që Monika Kryemadhi ka patur në bashkëpronësi me Drini Kryemadhin, trualli i të cilës i është dhënë me kontratë sipërmarrje për ndërtim pallati, kompanisë Agi Kons, në vitin 2008. Në datën 25 Mars 2010 (deklarata për vitin 2009), Ilir Meta deklaroi se ka ndryshuar adresë dhe ka banuar në pallatin Fratari, kati i pestë. Në deklarin e datës 02 Mars 2023, Mirvjen Nino ka deklaruar se:... *“Nga sa mbaj mend në Tetor ose Nëntor të vitit 2007, të gjithë ambientin ia kemi dhënë me qira Monika Kryemadhit dhe mamasë së saj por kontratën e kemi bërë me mamën e saj, Fatime. ... Monika është takuar me Nikolën dhe kanë biseduar për apartamentin..... Rramë dakord për qiranë mujore në shumën 3000 Euro në muaj dhe kontrata u bë me Fatimen pasi ashtu donim vetë ata. Në katin poshtë që kishte katër dhoma jetonin fëmijët e Ilirit së bashku me Fatimen ndërsa në katin sipër që kishte vetëm një dhomë gjumi (pjesa tjetër ishte kuzhina dhe soxhorno) jetonte Iliri me Monikën. Apartamenti është dhënë me qira për një periudhë pak më shumë se dy vjetë dhe uji dhe energjia elektrike paguhej në emrin tim dhe të Kozetës. Lekët e qirasë i jepte gjithmonë Fatimja e cila ishte grua e rregullt në pagesa. Edhe kur Iliri me Monikën kur bënë ndonjë punim shtesë, merrnin në telefon Nikolën dhe pagesat i bënte Fatimja. Në dijeninë time pas shitjes së apartamentit, ata kanë bërë punime shtesë si veshje me lesh xhami, izolime të ndryshme por nuk e di se me kë i kanë bërë këto punime.*

Diku nga fundi i vitit 2009 fillimi i vitit 2010, Fatimja dhe Monika i kishin thënë Nikolës *“Ne duam ta blejmë këtë shtëpi”*. Nikola ma tha mua dhe vëllait tjetër që *“ata donin ta blenin shtëpinë”*. Unë isha kundër shitjes së apartamentit pasi më leverdiste më shumë ta jepnim me qira sesa ta shisja. Kam rezistuar tre muaj duke kundërshtuar vëllezrit por duke qenë se Kozeta kërkonte që të likujdonte kredinë dhe rasti ishte i mirë, rrashë dakord për ta shitur. Bisedat për shitjen dhe cmimin e shitjes e ka bërë Fatimja me vëllain tim, Nikolën. Çfarë bisedonim ata të dy me njëri tjetrin Nikola vinte na i thoshte mua dhe vëllait tjetër. Kozeta Fino kishte marrë vesh që do të bëhej shitja por nuk ishte pjesë e negociatave të shitjes. Me të ishte rënë dakord që do të bëhej shlyerja e plotë e kredisë si dhe do të merrte pjesën e saj të fitimit për ndihmën që kishte dhënë në marrjen e kredisë. Unë dhe vëllezrit e mi rramë dakord që ta shisnim jo më pak se 800 mijë Euro. Nga këto para, përveç likujdimit që na u bë nëpërmjet bankës nga Fatimja dhe Iliri, Nikola ka marrë në dorë edhe 130-150 mijë Euro nga Fatimja. Këtë fakt unë e kam mësuar nga Igleni, vëllai tjetër, i cili më tha se Nikola i kishte dhënë Kozetës 30.000 USD pas shitjes dhe vetë atij 30.000 Euro, ndërsa pjesën tjetër e kishte mbajtur vetë për të likujduar borxhet që kishte nga bixhozi.”

Në kontrollin e banesës së shtetasës Fatime Kryemadhi, u gjetën dhe u sekuestruan në cillësinë e provës materiale tre mandate bankare të cilët pasqyrojnë faktin që Mirvjen Nino kishte tërhequr nga llogaria e Fatimes në tre këste shumën 234.500 Euro,

të cilat sipas deklarimit të Mirvjenit kanë shërbyer për likuidimin e vlerës së apartamentit dubleks.

Llogaria banakre nr. 119835 rezulton se është celur në datën 08 Maj 2008 dhe adresa e mbajtësit të llogarisë është Monika Kryemadhi, rruga Brigada e 8-të, Pallati Fratari, Tiranë, fakt që tregon se shtetasit Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi kanë banuar që në fillim të vitit 2008 në apartamentin me numra pasurie 3/64+1-8 dhe 3/64+1-9 që ndodhet në kryqëzimin e rrugës "Vaso Pasha" me rrugën "Brigada e 8-të".

Nisur sa më sipër, arriet në konkluzionin se deklarimi i shtetasit Mirvjen Nino përputhet me faktet dhe provat e siguruara gjatë hetimit, pasi Monika Kryemadhi dhe Ilir Meta kanë deklaruar ndryshimin e adresës së banimit nga rruga Teodor Keko në rrugën Vaso Pasha në vitin 2008, para se ata të lidhnin kontratën e shitblejres së apartamentit nga Credins Bank, dhe likuidimit të parave ndaj Mirvjen Ninos.

Duke qenë se Fatime Kryemadhi e ka blerë apartamentin e saj nga shtetasja Kozeta Fino në datën 10 Mars 2010, nisur nga fakti se deklarimi i interesave private i datës 25 Mars 2010 është bërë për vitin kalendarik 2009, arriet në konkluzionin se Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi në këtë periudhë kohore kanë jetuar në apartamentin që Mirvjen Nino u ka dhënë me qera sipas kontratës nr. 3267/635 datë 30 Qershor 2009 që Mirvjeni ka lidhur me shtetasen Fatime Kryemadhi, për shumën 3000 Euro në muaj. Kjo përputhet dhe me përmbajtjen e kontratës, se apartamenti është marrë me qira që prej muajit Shkurt 2008. Në rastin konkret, shtetasja Fatime Kryemadhi si qiramarrëse nuk ka bërë pagesë të qerasë nga llogaritë bankare, përkundrazi, kjo shtetase ka financuar me para cash llogaritë bankare të Monika Kryemadhit. Gjithashtu Fatime Kryemadhi nuk ka patur mundësi financiare për të bërë pagesë cash të qerasë, pasi ajo është në pamundësi financiare për të siguruar të ardhura mujore në shumën 3.000 Euro, ndërkohë që sikurse u konstatua gjatë gjithë periudhës kohore të ekzistencës së qirasë, deri në blerjen e apartamentit ajo ka paguar për këtë qëllim mbi 70.000 Euro. Si rrjedhojë arriet në konkluzionin se këto pagesa në shumën 70.000 Euro nuk kanë një burim të ligjshëm, por janë shuma monetare të siguruara nga veprimtaria e korrupsionit (*shumë e cila i shtohet shumës prej 138.000 Euro që Fatimja ka paguar për të likuiduar kreditë e çiftit Metaj-Kryemadhi*).

Në vijim të verifikimit të transaksioneve bankare të kryera nga Fatime Kryemadhi rezulton se në datën 23 Qershor 2010, Fatime Kryemadhi ka derdhur cash në llogarinë bankare nr. 233624, shumën prej 246.000 USD që sipas deklarimit të saj në bankë e kanë origjinën nga shitja e një trualli tek kompania Agi Kons. Po atë ditë, shumën 246.000 USD i ka transferuar me konvertim 200.000 Euro, në llogarinë në Euro në të cilën ishte disbursuar kredia dhe ka likuiduar një pjesë të kredisë.

Në datën 05 Nëntor 2010, Fatimja arkëton cash në llogarinë 219118, shumën 42.000 Euro të cilën e transferon te banka Credins për likuidim të kështit të kredisë.

Në datën 13 Nëntor 2010 Fatimja ka derdhur cash 72.000 Euro si të ardhura nga kompania Agi Kons.

Në datën 30 Nëntor 2010 Fatimja depoziton cash shumën 30.000 Euro si të ardhura nga kompania Agi Kons dhe po në këtë datë paguan si kësht kredie shumën 95.725 Euro duke mbyllur kredinë e marrë në muajin Mars 2010 në shumën 335.000 Euro.

Në depozitimet cash të parave nga data 23 Qershor 2010 deri në datën 30 Nëntor 2010, Fatime Kryemadhi ka deklaruar se ka patur të ardhura nga kompania Agi Kons, humën 246.000 USD dhe shumën 100.000 Euro.

Në deklarimin e tij, shtetasi Gentjan Sula, ortaku i vetëm i kompanisë Agi Kons, rezulton se ai dhe kompania nuk ka transferuar ndonjëherë fonde për blerje trualli tek shtetasja Fatime Kryemadhi. Të vetmet fonde që ai ka transferuar në llogarinë e Fatime Kryemadhit janë dy shuma nga 50.000 Euro përkatësisht në 25 Korrik 2008 dhe 13 Dhjetor 2009 dhe një shumë prej 5.000 Euro në datën 23 Mars 2012, çka në fakt përputhet dhe me transaksionet bankare.

Si konkluzion rezulton se nga analiza e transaksioneve bankare, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve, shtetasja Fatime Kryemadhi nuk justifikon me burime të ligjshme paratë e depozituara cash në vlerën 135,000,000 leke (konvertuar në 98,000 Euro) të derdhura cash në datën 10 Maj 2010, shumën 246.000 USD dhe 100.000 Euro të deklaruar si të ardhura nga kompania Agi Kons. Këtyre shumave i shtohet edhe shuma prej 310.000 Euro të cilat Fatimja i përdori për të blerë apartamentin e shtetases Kozeta Fino (240 mijë Euro të depozituara në datën 08 Mars 2010 në llogarinë 216273 në Credins Bank; 8.500.000 lekë të depozituara në datën 08 Mars 2010 në llogarinë dhe 10.000 Euro të depozituara në datën 09 Mars 2010 në llogarinë 082245 në bankën Emporiki), si dhe shuma prej 138.000 Euro të cilat janë derdhur cash nga Fatimja në llogarinë nr. 119835 të Monikës për peridhën Shkurt-Dhjetor 2009.

Në total Fatime Kryemadhi nuk ka burim të ligjshëm për të ardhurat e depozituara cash në periudhën 2009-2010 në vlerën, 13,500,000 lekë, 548.000 Euro dhe 246.000 \$. *Të konvertuara në Euro, referuar të dhënave bankare shuma totale për të cilat Fatime Kryemadhi nuk justifikon burimin e të ardhurave shuma kap vlerën 846,000 Euro.*

Sa më sipër arriet në konkluzionin se shtetasit Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi në deklaratën e interesave private vjetore të vitit 2009, kanë bërë deklaram të rremë të pasurive dhe interesave private, pasi nuk kanë deklaruar shpenzimet për pagesën e qerasë së apartamentit në të cilin kanë banuar para se ta

blenin, si dhe nuk kanë deklaruar financimin me para cash në vlerën 138.000 Euro që Fatime Kryemadhi i ka bërë kredive dhe overdraftit që Monika Kryemadhi ka marrë në Bankën Credins, duke konsumuar veprat penale *“Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i cdo personi që ka detyrimin ligjor për deklarim”* parashikuar nga neni 257/a i K.Penal, si dhe *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*, i kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 dhe 25 i Kodit Penal. Shtetasja Fatime Kryemadhi dyshohet se kanë konsumuar veprën penale *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*, i kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 dhe 25 i Kodit Penal.

Shtetasit Monika Kryemadhi dhe Ilir Metaj në deklaratën e interesave **private vjetore të vitit 2010** të pasurive dhe interesave private, kanë bërë deklarim të rremë lidhur me burimin e financimit, për blerjen e apartamentit me nr. pasurie 3/64+1-9, ndodhur në rrugën “Vaso Pasha”, nuk kanë deklaruar shpenzimet e qirasë së apartamentit nr. pasurie 3/64+1-9 deri në periudhën e blerjes, si dhe ka dyshime se kanë bërë deklarim të rremë të pasurisë pasi apartamenti i regjistruar në pronësi të Kozeta Finos, rezulton se është pronë e shtetasve Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi e fshehur në emrin e Fatime Kryemadhit.

Ata nuk kanë deklaruar se financimi në vlerën 200.000 Euro për blerjen e apartamentit me numër pasurie 3/64+1-9 është kryer nga Fatime Kryemadhi, por kanë deklaruar se shuma prej 200.000 Euro ka qenë gjendje cash nga shitja në vitin 2006 e vilës në Golem, Kavajë, **ndërkohë që nëse ata do ti kishin këto shuma parashë cash, nuk kishte pse Fatimja të financonte në një kohë shumë të shkurtër llogaritë bankare të tyre në këtë vlerë, madje dhe më shumë.** Ky përfundim bazohet në faktin se Fatime Kryemadhi përveç se ka paguar shumën 310.000 Euro, ka paguar edhe tatimin e pronës që në rastin e shitjes së një pasurie paguhet nga pronari i pasurisë në lidhje me kredinë e marrë prej saj me qëllim financimin e blerjes së apartamentit prej shtetases Kozeta Fino Nr. 3/64+1-8. Shtetasja Fatime Kryemadhi e ka financuar shlyerjen e kredisë që ka marrë prej 335.000 Euro nga para të derdhura cash në vlerën 246.000 USD dhe para të tjera burimi i të cilave nuk është ai i cili është kompania Agi Kons e deklaruar nga Fatimja, dhe si rrjedhim dyshohet se janë para të fituara në mënyre të paligjshme. Nga analiza financiare që iu bë të ardhurave dhe shpenzimeve të pasqyruara në llogaritë bankare të Fatime Kryemadhit rezultoi se kjo shtetase, në vitin 2010, ka balancë negative në shumën **846,000 Euro.**

Në këto rrethana lidhja e kontratës me shtetasen Kozeta Fino nga ana e Fatime Kryemadhit, marrja prej saj e kredisë bankare, si dhe financimi me këto të ardhura i një pjese të apartamentit të blerë nga Ilir Metaj e Monika Kryemadhi Nr.

3/64+1-9, ndërkohë që vetë Fatimja në këtë kohë ishte pensioniste, është bërë me qëllim për të futur në sistemin bankar shuma monetare që burojnë nga veprimtari të paligjshme sikurse është dhe vepra penale e “Korrupsionit”. Me qëllim për të mos përdorur për blerjen e apartamenteve këto shuma parashë me origjinë korruptive, është përdorur si truk marrja fillimisht e dy kredive bankare, dhe më pas shlyerja e kredive nëpërmjet depozitimit Cash pa burim të ligjshëm nga Fatime Kryemadhi, me deklarimin e burimeve të paqëna sikurse është rasti i shtetasit Gentjan Sula me qëllim shlyerjen e kredive, është arritur që të futen në sistemin bankar një shumë e pajustificuar parashë prej 846,000 Euro.

Për këtë shumë parashë, Fatimja nuk ka dhënë asnjë shpjegim të besueshëm, por thjesht është përpjekur që të justifikojë këto para me të ardhura të siguruara nga huatë, pasqyruar kjo në deklarata noteriale të paraqitur nga shtetas të ndryshëm, të cilët paraqiten si huadhënës, duke përfshirë dhe personin nën hetim Ema Çoku. Këto deklarata noteriale, jo vetëm që janë përpiluar pas pyetjes së shtetasit Fatime Kryemadhi, por në sistemin bankar nuk ka asnjë të dhënë për marrjen e shumave monetare, dhe as për shlyerjen e tyre ndonëse ka kaluar një periudhë kohore prej 15 vjet nga ndodhja e fakteve.

Më konkretisht, në deklarimet saj shtetasja Fatime Kryemadhi, e pyetur në lidhje me të ardhurat të cilat i ka përdorur për të blerë pasuri të paluajtshme, si dhe ato të përdorura për likuidimin e kredive që ajo vetë ka marrë, por edhe ato të marra nga vajza Monika Kryemadhi dhe që janë financuar nga Fatimja, deklaroi se me ardhjen e demokracisë kishte dhënë me qira një pjesë të apartamentit 3+1 që kishte te zona e Shallvareve, dhe nga qiraja përfitonte një mijë marka në muaj. Kjo shumë u pagua për gati dy vjet, por nuk kishte lidhur një kontratë qiraje para noterit. Bashkëshorti i saj, Ramazani, pas daljes në pension në vitin 1992, punoi si kambist ndërsa djali, Drini ka punuar si furxhi si dhe si DJ në disko Albania. Në vitin 1990, sipas deklaruës, ishin pajisur me leje ndërtimi nga këshilli i fshatit Mëzes dhe kishin ndërtuar një shtëpi me sipërfaqe 100 m² dhe truall 400 m². Pas ndërtimit të shtëpisë në Mëzes, Fatimja deklaroi se kishte dhënë me qira apartamentin që kishte te Shallvaret, me qira mujore 500 USD për një periudhë 2-3 vjeçare dhe për këtë kishte lidhur edhe kontratë qiraje te Noteri. Më pas shtëpinë ia kishte dhënë me qira një shoqërie greke për shumën një milionë e gjysëm lekë, dhe me të ardhurat e siguruara arriti të blente nga komshiu apartamentin e tij për vlerën 35 milionë lekë. Pasi i bashkoi të dy apartamentet, ia dha përsëri me qira shoqërisë greke, duke rritur qiranë në dy milionë e gjysëm lekë në muaj dhe qiraja zgjati tre vjet. Deklaruesja në vijim sqaroi se kishte blerë tokë bujqësore nga një person që quhej Lym, por nuk e mbante mend shumën me të cilën kishte blerë tokën. Këtë tokë e bleu pasi Gent Sula do të

bënte një pallat te toka që bashkëshorti kishte përfituar me ligjin 7501, por ndërtuesi kërkonte më shumë sipërfaqe toke nga sa ata kishin. Për ndërtimin e pallatit, kishin biseduar me disa shoqëri, emrat e të cilëve Fatimja deklaroi se nuk i mbante mend por nuk kishin rënë dakord. Nga ndërtimi, Fatimja do të përfitonte 19 hyrje, ndërsa numrin e dyqaneve dhe garazheve nuk e mbante mend. Sipas deklaruës, kompania Agi Kons përveç sipërfaqes ndërtimore i kishte dhënë asaj edhe një sasi lekësh, shumën e të cilave nuk e mbante mend. Nga të ardhurat e qirasë dhe nga të ardhurat nga puna e saj, Fatimja kishte blerë edhe një apartament 1+1 në vendin e quajtur Dolce Vita në Durrës. Këtë apartament më vonë e kishte shitur por nuk mbante mend as çmimin e blerjes dhe as atë të shitjes. **Në lidhje me apartamentet që ajo kishte blerë nga kompania Bjorn shpk, Fatimja deklaroi se i kishte blerë këto apartamente me paratë që njerëzit i kishin hedhur për ngushëllim kur i vdiq bashkëshorti. Fatimja nuk mbante mend se sa lekë i kishte blerë apartamentet por mbante mend se likujdimin e kishte bërë nëpërmjet bankës. Fatime Kryemadhi deklaroi se nga paratë që njerëzit i kishin dhënë për ngushëllim ishin mbledhur rreth 100 milionë lekë të vjetra, dhe apartamentet që bleu me këto të ardhura i shkëmbeu më vonë me apartamentin ku banonte Lefteri Haxhiu, te pallati i Fratarit në ish bllok, ku jetonte me Monikën.** E pyetur se çfarë toke i kishte shitur shtetasit Gentjan Sula, për vlerën 246.000 USD, fakt ky i deklaruar në bankën ku kishte depozituar paratë, Fatime Kryemadhi deklaroi se ajo nuk e kujtonte këtë veprim bankar dhe nuk mund të thoshte asnjë gjë lidhur me të. E pyetur për origjinën e parave që kishte depozituar në bankën Credins në datën 8 Mars 2010, përkatësisht 240.000 Euro dhe 8.500.000 Lekë, Fatime Kryemadhi deklaroi se ato para i kishte marrë borxh nga njerëzit e saj të afërt dhe konkretisht nga Bujare Ahmetaj që jetonte në Strugë, Sadete Lami që ishte nusja e nipit të saj dhe punonte farmacistë dhe prej djalit, Drinit. Fatimja shtoi se Drinit i kishte marrë 160 milionë lekë borxh, ndërsa nuk mbante mend se sa para i kishte marrë Bujares dhe Sadetes. Paratë e sipër përmendura, Fatimja deklaroi se i duheshin për të blerë hyrjen ku ajo, Monika dhe Iliri jetonin me qira. Sipas deklaruës, pasi kishte dhënë për ndërtim të pallatit, shtëpinë dhe truallin në Mëzes, kishin marrë me qira nga Mirvjen dhe Sokol Nino, dy apartamente që lidheshin me njëri tjetrin me shkallë të brendshme dhe që formonin një apartament dubleks. Qiraja ishte 2-3 mijë Euro në muaj dhe sipas deklaruës, me qira jetuan rreth 4 muaj pastaj apartamentin e blenë. Ajo pagoi për pjesën e saj rreth 320 mijë Euro, dhe lekët ia likujdoi Kozeta Finos nëpërmjet bankës. Fatimja deklaroi se ajo nuk priti që të miratohej një kredi bankare për të blerë apartamentin e Kozetës, por morri para borxh pasi apartamenti i Kozetës rrezikohej që të konfiskohej nga banka për shkak të një kredie të pashlyer. Me paratë që morri nga kredia, Fatimja deklaroi se bëri likujdimin e borxhit që kishte marrë nga Sadetja dhe Bujarja, ndërsa Drinit i likujdoi vetëm një pjesë por shumën

nuk e mbante mend. Fatime Kryemadhi u pyet se cila ishte arsyeja 234.000 Euro nga paratë e disbursuara nga banka në datën 29 Mars 2010, për kredinë e marrë, ishin tërhequr nga Mirven Nino dhe Fatimja deklaroi se 200.000 Euro i tërhoqi Mirvjeni, pasi ata ia blenë apartamentin Mirvejnit ndërsa 34.000 Euro, Mirvjeni i tërhoqi pasi do të paguante hipotekën. Pyetjes se cila ishte arsyeja që në datën 29 Mars 2010 i kishte transferuar Monikës shumën 100.000 Euro nga paratë e disbursuara të kredisë, Fatimja iu përgjigj se ia kishte transferuar Monikës me qëllim blerjen e apartamentit të saj, pjesë e dubleksit. Fatime Kryemadhi deklaroi se nuk e mbante mend burimin e shumës 1.800 000 Lekë që kishte depozituar në datën 30 Mars 2010 në Credins Bank.

Lidhur me shumën prej 100.000 Euro, që Fatimja kishte transferuar në llogarinë e Monika Kryemadhit në datën 26 Maj 2010, deklaroi se këtë shumë ia kishte dhënë Monika që ti depozitonte në bankë dhe Monika i kishte siguruar nga shitja e shtëpisë që kishte patur në Qerret. Sipas deklarueses, Monika nuk kishte patur kohë ti depozitonte vetë këto para për shkak të angazhimeve me partinë. E ripyetur përsëri lidhur me shumën prej 246.000 USD të konvertuara në vijim në shumën 200.000 Euro, e cila shërbeu për likuidimin e një pjese të kredisë, Fatimja deklaroi se ajo nuk mbante mend që shumën 246.000 USD t'a kishte marrë nga Gentjan Sula, por do të bënte verifikimet e saj dhe do të jepte shpjegime në një moment tjetër. E pyetur për depozitimet e parave cash për periudhën 5 Nëntor 2010-30 Nëntor 2010, shuma të cilat ishin përkatësisht 42.000 Euro, 43.000 Euro, 95.000 Euro, 72.000 Euro, dhe 30.000 Euro, Fatimja deklaroi se pasi të bënte verifikimet në bankë do të jepte sqarime, pasi në momentin e pyetjes, nuk e mbante mend se ku i kishte siguruar këto shuma.

Në vijim të deklarimit të saj, Fatime Kryemadhi sqaroi se ajo nuk ka kërkuar ndonjëherë të blejë shtëpi në Rolling Hills por vajza e saj, Monika kishte dashur të blente shtëpi por arsyen se përse nuk e bleu, ajo nuk e dinte. Fatimja deklaroi se ajo dispononte një llogari bankare të përbashkët me Era Metaj, në vlerën 100.000 POUND, të cilat i ka premtuar që Era ti përdorë për mbulimin e shpenzimeve të shkollës.

E pyetur për kartën e saj të kreditit, Fatime Kryemadhi deklaroi se kartën e saj të kreditit e ka përdorur Bora Metaj, gjatë kohës që kryente studimet në Angli si dhe Era Metaj me raste të rralla. Bora me kartën e saj ka kryer pagesat për mobilimin e apartamentit që morri me qira në Londër dhe shpenzime të tjera dhe gjatë qëndrimit të saj në Londër kartën e mbante Bora. Paratë që janë shpenzuar nga karta e saj, Fatimja deklaroi se i ka siguruar nga shitja e apartamenteve, pjesë takuese e saj në pallatin e ndërtuar nga Agi Kons Shpk.

Bazuar në faktet dhe provat e sipërcituara, rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se shtetasit Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi në bashkëpunim midis tyre dhe me Fatime Kryemadhin në vitin 2009-2010, kanë konsumuar elementë të veprës penale të *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, i kryer

në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Me qëllim për të mos përdorur për blerjen e apartamenteve shuma parashë me origjinë korruptive, apo të pajustificuara ndërkohë që në këtë periudhë kohore Ilir Meta akuzohet edhe për një fakt korupsioni në lidhje me shtetasin Kastriot Ismailaj, është përdorur si truk marrja fillimisht e dy kredive bankare. Më pas është bërë shlyerja e kredive nëpërmjet depozitimit Cash pa burim të ligjshëm nga Fatime Kryemadhit, ose me deklarin e burimeve të paqëna sikurse është rasti i shumave të deklaruara si të përfituara nga Gentjan Sula, dhe është arritur që të futen në sistemin bankar një shumë e pajustificuar parashë prej 846,000 Euro.

Për këtë shumë parashë, Fatimja nuk ka dhënë asnjë shpjegim të besueshëm, por thjesht është përpjekur që të justifikojë ato me të ardhura të siguruara nga huatë, pasqyruar kjo në deklaratat noteriale të paraqitura nga shtetas të ndryshëm, të cilët paraqiten si huadhënës sikurse është rasti i Ema Çokut. Këto deklaratat noteriale, jo vetëm që janë përpiluar pas pyetjes së shtetasit Fatime Kryemadhi, por në sistemin bankar nuk ka asnjë të dhënë për marrjen e shumave monetare, dhe as për shlyerjen e tyre ndonëse ka kaluar një periudhë kohore prej 15 vjet nga ndodhja e fakteve.

Shtetasja Fatime Kryemadhi, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se ka konsumuar veprën penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, i kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pasi ajo nuk ka patur mundësi për të krijuar të ardhura në shumën 300.000 Euro, para të cilat i ka përdorur për të likuiduar kredinë e marrë, të cilën e përdori për të financuar Monika Kryemadhin dhe Ilir Metën për blerjen e apartamentit të regjistruar si pronë e Mirvjen Ninos, dhe as financimin e apartamentit të saj të blerë nga Kozeta Fino. Në këtë mënyrë Fatime Kryemadhi, rezulton se i ka marrë kreditë bankare, me qëllim për të futur në sistemin bankar, nëpërmjet pagimit të kësteve të kredive shuma monetare të cilat burojnë nga veprimtari e korupsionit. Pra shumat e parave të ligjshme të përfituara nga kreditë, janë kthyer në bankë me para të paligjshme të përfituara nga veprimtari korruptive. Në këtë mënyrë, ajo ka mbuluar natyrën e vërtetë të shumave monetare të siguruara në mënyrë të paligjshme.

Shtetasja Ema Çoku është lidhje e afërt familjare me shtetasit Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi. Kjo shtetase nëpërmjet punonjëses së saj, Vera Bazi, ka paguar në vitin 2013, për aktivitet argëtues të LRI-së, shumën 4.103.605 lekë, ka paguar në vitin 2013 me derdhje cash në bankë për llogari të Hotel Rogner, ka bërë donacione në vlerën 7.000 Euro në vitin 2016 për subjektin LSI, ka përpiluar deklaratë noteriale Nr. 630 Rep. Nr. 234 Kol. datë 06 Shkurt 2019 ku ka deklaruar se gjatë

viteve 2011-2019 i ka transferuar shtetasen Monika Kryemadhi në llogarinë e saj bankare shumë 16.000 Euro dhe 1.500.000 lekë për blerjet që Monika ka bërë me kartë për llogari të Ema Çokut, ka përpiluar deklaratë noteriale nr. 1846 Rep, nr. 897 Kol, datë 22 Maj 2024, nëpërmjet të cilës deklaron se në fillim të vitit 2010 i ka dhënë Fatime Kryemadhit, hua shumë 220.000 Euro.

Kompania e saj B.S.K shpk, ka paguar në vitin 2013, shpenzimet e akomodimit në Hotel Rogner për shtatë shtetas të huaj midis të cilëve edhe John Moreira dhe Patrick Faust, shumë 1.142.000 lekë, Vera Bazi, në datën 30 Prill 2013 ka derdhur cash në llogarinë e Hotel Rogner, shumë 10.000 Euro për shërbimin “ushqim dhe pije, banket i LRI-së”. Gjithashtu Vera Bazi në datën 11 Qershor 2014 ka derdhur cash në bankën Intesa Sanpaolo, shumë 300.000 lekë për shërbimin “event” i organizuar në datën 10 Qershor 2013 nga LRI” dhe në datën 25 Shtator 2014, ka derdhur cash shumë 363.910 lekë për shërbimin “event i organizuar në datën 10 Qershor 2013 nga LRI”.

Shtetasja Ema Çoku, dhe kompania e saj BSK shpk, kanë qenë vazhdimisht debitorë në bankat e nivelit të dytë për shkak të kredive në vlera të mëdha, si dhe të ardhurat e siguruara nga biznesi bazuar në bilancet e deklaruara në organet tatimore kanë qenë minimale.

Në datën 3 Qershor 2025, është administruar akti i ekspertimit kontabël nga ku rezultoi se personi nën hetim Ema Çoku, bazuar në dokumentacionin e analizuar lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 2002-2009, nuk ka patur mundësi për kursime me një diferencë negative progresive në vlerën – 84,045,935 lekë. Për vitin 2010, vit në të cilin Ema Çoku i ka dhënë hua Fatime Kryemadhit rezultoi me pamundësi në kursime në shumë – 58,949,293 lekë. Për periudhën 2002-2010, pamundësia ekonomike e personit nën hetim Ema Çoku, ka qenë në shumë -142,995,227 lekë.

Kjo shtetase nëpërmjet nënshkrimit të deklaratës noteriale Nr. 1846 Rep, Nr. 897 Kol, datë 22 Maj 2024, ku deklaron se në fillim të vitit 2010 i ka dhënë Fatime Kryemadhit, hua shumë 220.000 Euro, është përpjekur të ndihmojë Fatime Kryemadhin për të justifikuar shumën e parave që burojnë nga veprimet korruptive të Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi. Në këtë mënyrë Ema Çoku ka konsumuar veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, i kryer në bashkëpunim me Fatimen, parashikuar nga neni 287 paragrafi i II-të i Kodit Penal, por e kryer sipas pikës “dh” të paragrafit të parë të këtij neni, nëpërmjet ndihmës së dhënë për të fshehur ose mbuluar natyrën e vërtetë të produkteve të veprës penale.

Po kështu personat nën hetim Ilir Metaj e Monika Kryemadhi, rezultojnë se duke mos pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurive, dhe duke e paraqitur atë si të krijuar me burime të ligjshme, ndonëse pa i deklaruar të gjitha këto pasuri dhe burimet e tyre, kanë konsumuar në bashkëpunim elementët e figurës së veprës penale të *“Refuzimit për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike, ose i çdo personi i cili ka detyrimin ligjor për deklaram”* parashikuar nga nenet 257/a paragrafi i II-të i Kodit Penal, vepër e kryer në vitin 2011 nëpërmjet deklaratës të plotësuar në këtë vit, por vepra penale është shuar pasi kanë kaluar afatet e parashkrimit.

Nga sa më sipër, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga neni 248 i Kodit të Procedurës Penale, kërkojmë Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, verifikimin e kushteve të zbatimit të msave të sigurimit, çmojmë se vijon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm për të pandehurin Ilir Metaj, për të gjitha veprat penale për të cilat është regjistruar emri i tij në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, si dhe për të gjitha faktet objekt hetimi për të cilat është caktuar masa e sigurimit personal *“Arrest në burg”* parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale me vendimin Nr. 125 datë 20 Tetor 2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Po kështu aktualisht hetimet janë drejt fundit, të pandehurit Ilir Metaj e Monika Kryemadhi, përvec se janë pyetur me cilësinë e personave nën hetim, janë njoftuar dhe kanë qenë dakord për të kryer aktin e ekspertimit ekonomik-kontabël, i cili sikurse rezultojnë ka përfunduar vetëm para dyjavësh në datën 03 Qershor 2025, për shkak të volumit që paraqiste rasti.

Nga sa më sipër, çmohet se jo vetëm nuk është zbehur dyshimi i arsyeshëm i cmuar dhe vlerësuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në vendimin Nr. 125 datë 20 Tetor 2024, por përkundrazi ai përforcuar në drejtim të shumës së përfitime të marrëdhënies korruptive me Adrian Shatkun, si dhe të veprës penale të *“Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”* në të dyja episodet, si në kontratën e lobimit me Kompaninë Amerikane G.S.I.S. ashtu dhe me rastin e kontratës së kredisë bankare.

I vetmi episod që tashmë është vërtetuar se nuk ekziston si vepër penale, por që gjithsesi nuk e ndryshon kualifikimin ligjor të faktit që i atribuohet të pandehurit është ai i kontratës së lobimit me McKeon Group.

Në këto rrethana, bazuar dhe në nenin 246/6 dhe 260 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe Vendimin Unifikues Nr. 1 datë 08 Janar 2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, informojmë gjykatën në lidhje me ecurinë e hetimeve.

Po kështu duke qenë se tashmë, shtetasi Ilir Metaj është marrë i pandehur, dhe po përfundohen hetimet, jo vetëm që nuk është zbehur dyshimi i arsyeshëm që ka ekzistuar por ai është përforcuar. Në këto rrethana, masa e sigurimit duhet të vijojë të zbatohet.

Po kështu duke qenë se nuk ka asnjë provë që të zbehe dyshimin e arsyeshëm për të pandehurin, si të administruar gjatë hetimit ashtu dhe të paraqitur nga mbrojtësi apo që të bëjë që të mos ekzistojnë kushtet për të zbatuar masën e sigurimit të caktuar me vendimin Nr. 125 datë 20 Tetor 2024 dhe për rrjedhojë dhe kërkesa e mbrojtësit për zëvendësimin e masës së sigurimit duhet rrëzuar.

Për këto arsye dhe në bazë të nenit 246/6 dhe 260/2 të Kodit të Procedurës Penale,

K E R K O J M Ë:

1. Vijimin e zbatimit të masës së sigurimit *“Arrest në burg”* parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin Nr. 125 datë 20 Tetor 2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj të pandehurit **Ilir Metaj**, i biri i Rexhepit dhe Fiqiretes, i datëlindjes 24 Mars 1969, lindur në Çepan, Skrapar, me adresë banimi Tiranë, Rr. *“Vaso Pasho”*, Nd. 1817, H. 0, Ap. 005 ose pranë Partisë së Lirisë, Sheshi Eëllson, me shtetësi Shqiptare, gjendja familjare i martuar, me nr. Personal G90324055M, i dyshuar për kryerjen e veprave penale të *“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”* **në 3 (tre) raste nga të cilat në dy raste është kryer në bashkëpunim, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i cdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”** parashikuar nga nenet 260 dhe 25, 287/2 dhe 257/a/2 i K.Penal.
2. Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga mbrojtësi për zëvendësimin e masës së sigurimit si të pabazuar në ligj e në prova.

PROKURORË

Sotir KLLAPI